



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, Trupi Gjykses, më 25 maj 2023 miratoi kërkesën e mbrojtësit të viktimave për ndryshimin e masave mbrojtëse për viktimat pjesëmarrëse me qëllim lejimin e nxjerrjes së disa informacioneve për ekspertin që është caktuar të vlerësojë dëmet materiale që pretendohet se kanë pësuar viktimat në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses gjykoi se nxjerrja e disa informacioneve për ekspertin nuk përbën rrezik për viktimat pasi informacioni do të nxirret në kuadër të një vlerësimi profesional që do të kryhet nga një ekspert i pavarur që është angazhuar në të shkuarën në çështje gjyqësore të DHSK-së. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se viktimat kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Më 30 maj 2023, Trupi Gjykses në këtë çështje gjyqësore miratoi kërkesat e ZPS-së dhe të Mbrojtjes për të pranuar si prova materialet të përdorura gjatë pyetjeve drejtuar dëshmitarëve si fotografi, harta apo dëshmi të mëparshme. Gjithashtu, Trupi Gjykses pranoi si prova materialet e tjera të përdorura nga Trupi Gjykses, palët dhe mbrojtësi i viktimave.

Dëshmitari i shtatë i thirrur nga Prokuroria dëshmoi në gjykimin *Shala* këtë javë dhe do të vazhdojë me dhënien e dëshmisë edhe nesër. Dëshmitari dha dëshmi nën masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private. Trupi Gjykses bëri me dije se, sidoqoftë, pas mbarimit të dëshmisë së dëshmitarit, transkripti përkatës do të rishikohet dhe do të bëhet publik, për aq sa është e mundur. Vendimi i Trupit Gjykses për mbajtjen e seancave private merret rast pas rasti dhe arsyeja kryesore është mbrojtja e sigurisë dhe identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave.

Të hënën, më 29 maj, Zyra Administrative organizoi një vizitë nën ruajtje për Hashim Thaçin në Kosovë për të takuar anëtarët e familjes së ngushtë, në bazë të urdhrit të Trupit Gjykses. Trupi Gjykses miratoi kërkesën e z. Thaçi për këtë vizitë për arsye humanitare bindëse. I akuzuari vazhdoi të mbetej nën paraburgimin dhe ruajtjen e Dhomave të Specializuara përgjatë gjithë qëndrimit në Kosovë, me ndihmën edhe nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës. Z. Thaçi u rikthye në objektin e paraburgimit në Hagë më të njëjtën ditë.

Seancat në këtë çështje gjyqësore do të rifillojnë të hënën, më 12 qershor në orën 09:00.

Pyetje nga gazetarët

